



“NË UNIFORMË NUK KA GJINI – KA VETËM MERITË, DISIPLINË E MISION NDAJ ATDHEUT”

Intervistë me zëvendësministren e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrashda

» faqe 6



FORCA TOKËSORE PAJISËT ME SISTEMIN RAKETOR “JAVELIN”

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore të Republikës së Shqipërisë, në Zall-Herr, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të sistemit raketor “Javelin”, një kapacitet i ri dhe strategjik për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë ushtarak me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e ngarkuara me punë e SHBA-ve në Tiranë, Nancy VanHorn, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralletenant Arben Kingji, si dhe drejtues...

faqe 2



KLSM-16, NJË PLATFORMË STRATEGJIKE PËR LIDERËT E SIGURISË

Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e hapjes së Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje (KLSM-16), një program prestigjioz që synon përgatitjen e liderëve të ardhshëm në fushën e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrashda, zëvendësministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletenant Arben Kingji, komandantë të forcave kryesore...

faqe 4



ARKITEKTËT E MENDJES STRATEGJIKE, PROFESORËT QË FORMËSOJNË ELITËN E FORCAVE TË ARMATOSURA

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

7 Marsi - Dita e Mësuesit - Drita e dijes në shërbim të Atdheut: Profesorët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Më 7 Mars, në mbarë hapësirën shqiptare, përulemi me respekt para figurës së mësuesit, atij që ndez dritën e dijes dhe formon themelet e së ardhmes. Kjo datë përkujton hapjen e shkollës...

faqe 9



Rreth 200 studentë u diplomuan në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Në ambientet e auditoriumit në garnizonin “Skënderbej” u zhvillua ceremonia e ndarjes së diplomave për studentët që përfunduan ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA).

Diplomat u shpërndanë për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” (2020–2025) në programet:

- Studime në Shkenca Ushtarake
- Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes
- Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes

Si edhe për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” në programin:

- Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes

Rreth 200 studentë, ushtarakë dhe civilë, të cilët përfunduan studimet pranë Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, u pajisën me diplomat përkatëse, duke shënuar një etapë të rëndësishme në formimin e tyre profesional dhe akademik.

Të pranishëm në ceremoni ishin Rektori i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, drejtues dhe staf pedagogjik i institucionit, si dhe përfaqësues nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Në fjalët përshëndetëse u theksua rëndësia e përgatitjes akademike dhe profesionale të brezit të ri të ushtarakëve dhe specialistëve civilë në fushën e mbrojtjes, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe kërkesat e

Ceremonia e ndarjes së diplomave “Bachelor” dhe “Master Profesional” në AFA



mjedisit të sigurisë. Ky moment përbën një tjetër arritje për Akademinë e Forcave të Armatosura, menjëherë pas akreditimit si institucion i veçantë i arsimit të lartë, duke konsoliduar më tej rolin e saj në formimin e liderëve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Përmes programeve të saj studimore, AFA vijon të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve njerëzore, në modernizimin e Forcave të Armatosura dhe në përgatitjen e profesionistëve të aftë për t’u përgjigjur sfidave të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Akademia e Forcave të Armatosura në Kampionatin Botëror Ushtarak të Vrapimit në Terren

Përfaqësim dinjitoz në edicionin e 60-të të CISM në Greqi

Ekipi i Akademisë së Forcave të Armatosura mori pjesë në edicionin e 60-të të Kampionatit Botëror Ushtarak të Vrapimit në Terren, organizuar nga International Military Sports Council, i zhvilluar në Trikala, Greqi.

Ky aktivitet prestigjioz ndërkombëtar mbledhi sportistë ushtarakë nga vende të ndryshme të botës, duke krijuar një arenë konkurrimi të nivelit të lartë, ku përgatitja fizike, disiplina dhe fryma e bashkëpunimit ushtarak u ndërthurën me garën sportive.

Ekipi shqiptar u përfaqësua nga trajnerë, sportistë dhe studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilët garuan me profesionalizëm dhe përkushtim, duke përballuar me sukses sfidat e këtij kampionati.

Përballë vendeve aleate pjesëmarrëse, ekipi shqiptar përfaqësoi me dinjitet Shqipërinë, duke arritur rezultate të vlerësueshme dhe duke konfirmuar nivelin konkurrues të sportistëve të Forcave të Armatosura.

Pjesëmarrja në këtë kampionat botëror përbën një tjetër dëshmi të angazhimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të qenë pjesë aktive e aktiviteteve sportive ushtarake ndërkombëtare, si dhe për të promovuar vlerat e disiplinës, qëndrueshmërisë dhe bashkëpunimit në kuadër të komunitetit ushtarak global.

Ky përfaqësim në arenën sportive ndërkombëtare është një tregues i qartë i profesionalizmit dhe përgatitjes së lartë të efektivëve tanë, të cilët vijojnë të nderojnë uniformën shqiptare jo vetëm në misionet operacionale, por edhe në aktivitete sportive të nivelit botëror.



Ekipe EOD, në mbështetje të emergjencave civile në Selenicë

Asgjësohen municione të gjetura gjatë punimeve në lumin Shushicë

Ekipi i specialistëve EOD (Explosive Ordnance Disposal) i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i angazhuar në mbështetje të emergjencave civile në Bashkia Selenicë, ka vijuar edhe gjatë ditës së sotme detyrën për vlerësimin dhe largimin e municioneve luftarake të konstatuara në terren.

Gjatë punimeve për ndërtimin e urës mbi lumin Shushicë, në fshatin Kotë, janë zbuluar municione të kalibrave të ndryshëm, çka ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen e menjëhershme të ekspertëve të specializuar EOD.

Pas sigurimit të perimetrit dhe kryerjes së procedurave standarde të verifikimit dhe vlerësimit të rrezikut, specialistët kanë bërë të mundur largimin në mënyrë të kontrolluar të municioneve, duke eliminuar çdo kërcënim potencial për jetën e punëtorëve dhe banorëve të zonës.

Ndërhyrja profesionale e ekipeve EOD mundësoi rikthimin e kantierit të ndërtimit në një zonë të sigurt, duke i hapur rrugë vijimit normal të punimeve për ndërtimin e urës.

Forcat e Armatosura mbeten të angazhuara në mbështetje të autoriteteve vendore dhe komunitetit, duke garantuar reagim të shpejtë dhe profesional në çdo rast që paraqet rrezik për sigurinë publike.



FORCA TOKËSORE PAJISËT ME SISTEMIN RAKETOR “JAVELIN”

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore të Republikës së Shqipërisë, në Zall-Herr, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të sistemit raketer “Javelin”, një kapacitet i ri dhe strategjik për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë ushtarak me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e ngarkuara me punë e SHBA-ve në Tiranë, Nancy VanHorn, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji, si dhe drejtues e efektivë të Forcës Tokësore.

NJË HAP I RËNDËSISHËM NË MODERNIZIMIN E MBROJTJES

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi se dorëzimi i sistemit “Javelin” përfaqëson një moment të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe në thellimin e partneritetit strategjik me SHBA-të.

“Sot dorëzojmë në Forcën Tokësore sistemin “Javelin”, në tërësinë e këtij komponenti të porositur prej vitesh dhe pjesë e një bashkëpunimi të ngushtë me SHBA-të. Ky sistem nuk është thjesht një simbol force dhe kapaciteti, por edhe një mesazh qartësie strategjike”, – u shpreh ministri.

Ai nënvizoi se investimet në mbrojtje janë domosdoshmëri për garantimin e sigurisë kombëtare dhe për parandalimin e krizave të mundshme.

“Kostoja e përgatitjes është gjithnjë më e vogël sesa kostoja e pa-përgatitjes. Shqipëria ka zgjedhur të investojë në kohë paqeje, me plan dhe disiplinë buxhetore, për të rritur besueshmërinë dhe për të shkurajuar rreziqet me kapacitete reale”, – deklaroi ai.

Ministri theksoi qartë karakterin mbrojtës të këtij investimi: “Shqipëria nuk armatohet për të sulmuar askënd, por në mënyrë që askush të mos e vërë në provë”.

Në përfundim, ai e cilësoi drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes si një privilegj dhe mbrojtjen si një nga shtyllat themelore të shtetit shqiptar.

SHBA: DËSHMI E PËRKUSHTIMIT NDAJ SIGURISË RAJONALE

Nga ana e saj, e ngarkuara me punë e SHBA-ve, Nancy VanHorn, e cilësoi furnizimin me sistemin “Javelin” si një hap të rëndësishëm në zhvillimin e partneritetit të sigurisë



mes dy vendeve dhe një dëshmi konkrete të përkushtimit amerikan ndaj stabilitetit rajonal.

“Furnizimi i këtyre raketave ‘Javelin’ nga Shtetet e Bashkuara është një dëshmi konkrete e përkushtimit tonë për sigurinë rajonale dhe forcën e aleancës së NATO-s”, – u shpreh ajo.

Diplomatja amerikane theksoi se sistemi përfaqëson teknologji të avancuar ushtarake dhe rrit ndjeshëm aftësitë operacionale të forcave që e përdorin.

“Këto sisteme u mundësojnë operatorëve të zhvendosen menjëherë pas gjuajtjes dhe kanë aftësi sulmi nga lart, duke goditur pikën më të dobët të blindimit armik”, – deklaroi VanHorn.

Ajo vlerësoi gjithashtu rolin aktiv të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe theksoi rëndësinë e rritjes së investimeve në mbrojtje dhe modernizimin ushtarak, në përputhje me përgjegjësitë e përbashkëta të aleatëve në kuadër të NATO-s.

“JAVELIN” – TEKNOLOGJI E GJENERATËS SË FUNDIT

Sistemi “Javelin” është një sistem raketer kundërtank i gjeneratës së fundit, i prodhuar nga SHBA-të dhe i përdorur gjerësisht nga ushtritë e vendeve anëtare të NATO-s, si dhe



në operacione reale luftarake. Ai karakterizohet nga:

- Aftësi e lartë goditjeje ndaj mjeteve të blinduara;
- Sistem drejtimi të avancuar me teknologji “fire-and-forget”;
- Aftësi për goditje nga lart, duke synuar pikën më të dobët të objektivit;
- Mundësi zhvendosjeje të menjëhershme të operatorit pas lëshimit të raketës.

Shqipëria e ka porositur sistemin “Javelin” në kuadër të programeve të bashkëpunimit ushtarak me SHBA-të, përmes mekanizmave të shitjeve ushtarake të huaja (Foreign Military Sales – FMS).

NJË INVESTIM NË PARANDALIM DHE BESUESHMËRI

Ky investim përbën një hap konkret në strategjinë afatgjatë të modernizimit të Forcave të Armatosura, rritjes së kapaciteteve të parandalimit dhe përafrimit të plotë me standardet, kapacitetet dhe doktrinën e NATO-s.

Pajisja e Forcës Tokësore me sistemin “Javelin” forcon më tej aftësinë mbrojtëse të vendit, rrit ndërveprueshmërinë me aleatët dhe konfirmon angazhimin e Shqipërisë për të qenë një kontribuuese e besueshme në arkitekturën euroatlantike të sigurisë.

Efektivët e Komandës Mbështetëse dhurojnë gjak

Kontribut konkret në shërbim të jetës dhe solidaritetit

Në ambientet e Qendrës Shëndetësore të Komandës Mbështetëse, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, u zhvillua një aktivitet për dhurimin vullnetar të gjakut, në kuadër të nismave humanitare në mbështetje të qytetarëve në nevojë.

Efektivë të Komandës Mbështetëse iu bashkuan kësaj nisme me përgjegjësi dhe përkushtim, duke dhuruar gjak si një akt solidariteti dhe humanizmi, me mesazhin se së bashku mund të dhurojmë shpresë dhe jetë për ata që përballen me situata të vështira shëndetësore.

Ky aktivitet dëshmon edhe njëherë angazhimin e strukturave të Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë jo vetëm në përmbushjen e misioneve operacionale, por edhe në shërbim të komunitetit dhe në mbështetje të sistemit shëndetësor në vend.

Kontributi i efektivëve do të vijojë edhe në ditët në vijim, me përfshirjen e strukturave të tjera vartëse të Komandës Mbështetëse, duke e kthyer këtë nismë në një angazhim të vazhdueshëm në shërbim të jetës dhe solidaritetit qytetar.





KLSM-16, NJË PLATFORMË STRATEGJIKE PËR LIDERËT E SIGURISË

Starton në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen

Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e hapjes së Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje (KLSM-16), një program prestigjioz që synon përgatitjen e liderëve të ardhshëm në fushën e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministrija e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, zëvendësministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandantë të forcave kryesore dhe autonome të FARSH-së, atashe ushtarakë të akredituar në Shqipëri, drejtore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të sigurisë dhe staf akademik.

SIGURIA NË NJË BOTË TË PASIGURT

Në fjalën e saj, znj. Abrazhda theksoi rëndësinë e kursit në përgatitjen e udhëheqësve të së nesërme, duke e vendosur theksin te realiteti i ri i sigurisë globale: “Siguria sot nuk është çështje kufijsh apo forcash konvencionale. Lufta në Ukrainë vazhdon të ridimensionojë arkitekturën e sigurisë së Europës. Zhvillimet në Lindjen e Mesme na rikujtojnë se sa shpejt tensionet mund të rriten dhe si mund të bëhet situata e sigurisë e brishtë. Krizat sot lëvizin më shpejt se diplomacia dhe aleancat nuk po testohen vetëm nga fjalët, por nga veprimet e koordinuara”.

Ajo nënvizoi se siguria nuk është më abstrakte, por imediate dhe e ndërlidhur, duke kërkuar udhëheqës që mendojnë qartë në kohë pasigurie. Profesionalizmi, sipas saj, nuk është krahasim me të tjerët, por forcim i strukturave që lejojnë institucionet të funksionojnë.

Zëvendësministrija theksoi gjithashtu se diversiteti i pjesëmarrësve në këtë kurs përbën një avantazh strategjik, pasi marrëdhëniet e krijuara gjatë tij mund të shërbejnë për të



parandaluar përshkallëzime, për të forcuar bashkëpunimin dhe për të mbështetur stabilitetin rajonal.

BASHKËPUNIMI SI DOMOSDOSHMËRI STRATEGJIKE

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, në fjalën e tij theksoi se kërcënimet moderne – konvencionale, kibernetike apo ideologjike – nuk njohin kufij. “Asnjë komb, pavarësisht sa i fuqishëm mund të jetë, nuk mund të sigurojë interesat e tij në izolim.”

Ai vuri në dukje se pjesëmarrësit do të përballen me sfida që kalojnë nga praktikat institucionale në vendimmarrje taktike dhe strategjike, duke i nxitur ata të mendojnë jashtë zonës së komfortit.



Gjenerali Kurti theksoi kontributin e oficerëve nga Polonia dhe Hungaria si bartës të një perspektive të gjallë të reziliencës europiane, ndërsa përfaqësuesit nga Kroacia, Italia, Greqia dhe Shqipëria i cilësoi si mbajtës të çelësave të sigurisë së kontinentit.

Në përfundim ai iu drejtua pjesëmarrësve me një mesazh motivues: “Ju jeni arkitektët e së ardhmes së sigurisë sonë. Studioni me përkushtim, ushtroni disiplinën dhe kultivoni unitetin, sepse mbi këto themele ngrihet mbrojtja e kombit”.

NJË PLATFORMË NDËRKOMBËTARE

Në KLSM-16 marrin pjesë 20 ushtarakë të lartë dhe



civilë nga Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Italia, Jordania, Polonia, Turqia, Kosova dhe Shqipëria, përfshirë përfaqësues të FARSH-së dhe profesionistë të institucioneve të sigurisë në vend.

Kursi synon aftësimin e ushtarakëve dhe civilëve të niveleve strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe institucione të tjera analoge. Programi ofron njohuri dhe trajnim analitik për çështje të mbrojtjes dhe sigurisë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

KLSM-16 zhvillohet në gjuhën angleze, ka kohëzgjatje tremujore dhe përfundon më 22 maj 2026.

GLOBALIZIMI DHE SIGURIA NJERËZORE

Në kuadër të programit akademik, pjesëmarrësit ndoqën një leksion të mbajtur nga prof. dr. Nicola Pedde, Drejtor i Qendrës për Studime Globale në Romë.

Ai trajtoi zhvillimet dhe efektet e globalizimit, ndryshimet në mjedisin ndërkombëtar të sigurisë, rolin e informacionit dhe ekonomisë si elementë të sigurisë kombëtare, si dhe dimensionin gjithnjë e më të rëndësishëm të sigurisë njerëzore.

Bashkëbisedimi u vlerësua si një kontribut me peshë akademike dhe strategjike për thellimin e analizës mbi

sfidat bashkëkohore.

BASHKËPUNIMI ME ALEATËT, MODEL PRAKTIK



Në vijim të programit mësimor 2025–2026, kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) zhvilluan një leksion me atashëun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, nënkolonel David Strong.




Leksioni me temë “Procesi i Planizimit Operacional” u zhvillua në garnizonin “Skënderbej” dhe u fokusua në hapat analitikë të planifikimit operacional sipas doktrinave të NATO-s dhe aleatëve.

Shefi i Departamentit Operacional Ushtarak, kolonel Ramadan Karakushi, theksoi se procesi i planifikimit përbën urrën lidhëse ndërmjet nivelit strategjik dhe atij taktik, duke e cilësuar leksionin si një vlerë të shtuar për përgatitjen profesionale të ushtarakëve.

Kjo orë mësimore shënoi gjithashtu nisjen e një praktike të re, ku kursantët do të zhvillojnë leksione dhe praktike mësimore në Akademinë e Mbrojtjes në Shrivenham, në Mbretërinë e Bashkuar, gjatë muajit mars 2026.

Në përfundim të aktivitetit, nënkolonel David Strong u nderua me një “Certifikatë Nderi” nga Komandanti i KMS-

së, dorëzuar në emër të tij nga kolonel Ramadan Karakushi.



DISIPLINA, THEMEL I LIDERSHIPIT

KLSM-16 konfirmon rolin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë si një shtyllë thelbësore në edukimin strategjik të elitës ushtarake dhe civile. Në një realitet ku kërcënimet janë gjithnjë e më të ndërlikura dhe dinamike, përgatitja intelektuale, disiplina dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mbeten elementët kyç për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit.

Ky kurs përfaqëson jo vetëm një program akademik, por një investim afatgjatë në sigurinë kombëtare dhe në forcimin e rolit të Shqipërisë si një aleate e besueshme në arkitekturën euroatlantike të mbrojtjes.

INTERVISTË ME ZËVENDËSMINISTREN E MBROJTJES, ZNJ. BLERINA ABRAZHDA

“NË UNIFORMË NUK KA GJINI



KA VETËM MERITË, DISIPLINË DHE MISION NDAJ ATDHEUT”

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefë e Sektorit të Botimeve

Znj. Blerina Abrazhda prej 12 shkurtit 2025, mban detyrën e zëvendësministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Ajo ka një përvojë të pasur ndërkombëtare në fushën e politikave të mbrojtjes dhe është e angazhuar për modernizimin e mbrojtjes së Shqipërisë dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak me aleatët globalë. Karriera e saj tregon përkushtim të thellë për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ajo ka bashkëpunuar me organizata të mëdha ndërkombëtare si NATO dhe Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së, duke e pozicionuar Shqipërinë si një partner të besueshëm dhe strategjik.

Në Ministrinë e Mbrojtjes, Abrazhda mbështet reformimin e politikave që rrisin efikasitetin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë. Ajo thekson inovacionin dhe bashkëpunimin për një forcë mbrojtëse të modernizuar dhe të përgatitur për sfidat e sigurisë.

Përpara se të bëhej zëvendësministre e Mbrojtjes, znj. Abrazhda ka punuar si drejtore Rajonale në “Lockheed Martin”, ku ka kontribuar në zhvillimin e partneriteteve të

sigurisë në Lindjen e Mesme. Ajo ka promovuar gjithashtu diversitetin gjinor në sektorin e Mbrojtjes, duke u bërë një nga gratë e para negociatore në këtë industri.

Znj. Abrazhda ka dy diploma master në Tregtinë Ndërkombëtare dhe Menaxhim Biznesi nga Universiteti “LUISS Guido Carli” dhe ka pasur përvojë të rëndësishme profesionale në kompani të njohura ndërkombëtare si “Leonardo” dhe Grupi “Mubadala”. Ajo ka jetuar jashtë për më shumë se 25 vjet në Itali, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe SHBA, duke sjellë një pasuri përvojë ndërkombëtare në punën e saj.

Zonja zëvendësministre, si e shihni 8 Marsin dhe çfarë do të thotë kjo ditë për ju personalisht dhe profesionalisht?

Unë gjithmonë 8 Marsin e kam parë si ditë kur festohet kulmimi i atyre që përbëjnë luftën e gruas për barazinë, e cila për mendimin tim personal nuk ka përfunduar asnjëherë, vazhdon ende. Unë përpjekjet e mia personale dhe profesionale nuk i kam ndaluar asnjëherë në festimin e 8 Marsit por i vazhdoj tutje, në aspektin praktik.

Ju e dini që diku 9 muaj më parë, ne nuk kishim asnjë grua ushtarake një-yllëshe dhe nëntë muaj më pas nga ardhja ime në këtë pozicion, kemi dy dhe unë jam shumë

e lumtur për këtë. Këto nuk kanë qenë avancime në kuadër të barazisë gjinore, por kanë qenë mirënjohje e punës së barabartë që bëjnë gratë dhe burrat, pra konsiderim i njëllotë i përpjekjeve të njerëzve në forcat e armatosura pa i ndarë në gjini, por duke i klasifikuar me arritjet e tyre personale.

Mendoj që arritja me e madhe e barazisë gjinore është kur gjinia nuk është as shkas dhe as arsye, as për promovim as për mungesë promovimi. Në një farë forme njerëzit në uniformë në veçanti duhet të jenë të pagjini, duhet të maten vetëm sukseset e tyre profesionale nuk duhet të bëhen dallime sipas gjinisë.

Shpesh në ushtri ka fjalë si: “por, kjo është grua, bën për këtë pozitë apo nuk bën për këtë pozitë...”, unë mendoj që çdo zonjë që i bashkohet forcave të armatosura jo vetëm të Republikës së Shqipërisë, por kudo ka marrë parasysh çdo sfidë që sjell angazhimi. Gjithkush që i afrohet uniformës dhe e vesh atë, mendoj që në mendjen e tyre për asnjë sekondë nuk ka oscilacione të mendimit: “jam grua” ose “jam burrë”, dhe mendoj që ky është uniteti më i madh gjinor, ndoshta sot në Shqipëri është në forcat e armatosura.

Unë personalisht e kam parë gjithmonë veten time në idenë që roli i nënës është që t’i tregojë fëmijës së saj se çfarë është e arritshme, jo vetëm se si ta edukosh fëmijën. Shembulli më i mirë për vajzën time 3-vjeçare sot, është që përmes meje të shohë që gjithçka është e mundur, nuk ka



Fatmirësisht Shqipëria ka gra në role drejtuese, ka pasur gra në role më të larta drejtuese në Qeveri dhe mendoj që Shqipëria nuk ka probleme në sensin e barazisë gjinore, ka më shumë probleme në syrin e perceptimit social të rolit të gruas, që fillon nga kultura familjare deri te kultura institucionale.

limite për shkak të gjinisë.

Si ka qenë rrugëtimi juaj profesional drejt pozicionit të Zëvendësministres së Mbrojtjes?

Unë kam ardhur në pozitën e zëvendësministres së Mbrojtjes si të thuash, kandidat teknokratik, unë vij nga industria e mbrojtjes dhe nga mbrojtja. E gjithë karriera ime, që nga dita zero e deri sot, që kanë kaluar mbi 15 vite, ka qenë në lidhje vetëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me staf ushtarak.

Unë vij nga industria e mbrojtjes, ku rëndom ndodh që njerëzit kryesor vijnë nga uniforma. Kam punuar me dy gjeneralë me tre yje dhe një gjeneral me 4 yje, kështu që gjithë jetën time u kam shërbyer njerëzve në uniformë, dhe nuk di si ta mendoj karrierën time ndryshe, përveç një karriere që i shërben njerëzve në uniformë.

Puna ime e përparshme ka qenë e lidhur ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe kryesisht me forcat operacionale, unë kam punuar në ofrimin e shërbimeve për sisteme të ndryshme të mbrojtjes, kam punuar për disa kompani të mëdha si “Lockheed Martin”, si dhe kam punuar në një rajon, i cili nuk është shumë mikpritës ndaj grave, që është Lindja e Mesme.

Unë jam gruaja e parë në Lindjen e Mesme që kam pasur një pozitë të tillë. Për shembull në Arabinë Saudite, ende ruaj me shumë kujdes disa letra që quhen “non objection letter” (letër jo kundërshtimi), që në atë kohë duhet t’i lëshonte babai ose bashkëshorti im, sepse në kulturën e tyre konsideroheshin që ata ishin gardiani im ligjor. Pra, unë si grua nuk kisha as autoritet të vendosja për lëvizjet e mia

profesionale, dhe siç e thashë, kam qenë gruaja e parë që kam hyrë në Forcat e Armatosura të Arabisë saudite, në vitin 2013.

Në vitin 2022, kam qenë e ftuar në një ceremoni, ku ka foto të publikuara, në të cilat jam së bashku me Princeshë Rimën, e cila është motra e Princit të Kurorës së Arabisë Saudite. Në vitin 2022 Arabia Saudite për herë të parë në historinë e Shtetit hapi forcat e armatosura për gratë.

Në 2013 unë kam hyrë një institucion, i cili në derë kishte një tabelë ku shkruhej “Gratë nuk lejohen të hyjnë në këtë institucion”. Mendoj që ky ka qenë revolucion i madh personal i imi si grua: të jesh prezente në një vend ku teknikisht nuk duhet të ekzistosh.

Këtu kam kuptuar që limitet janë shpesh mendore, janë kufizime që ne ia kemi shkaktuar vetes nga presioni social etj. Nuk ka qenë e re për mua përfshirja në Ministrinë e Mbrojtjes, pra nuk ka qenë diçka e re në eksperiencën time dhe në karrierë.

Jam shumë e kënaqur që Shqipëria është një nga vendet me përqindjen më të madhe të grave në Ministri të Mbrojtjes. Ne kemi 22 për qind personel zonja në Forcat e Armatosura, të cilat janë në të gjitha pozicionet, duke përfshirë pozita të larta drejtuese si Gjenerale e në të gjitha pozicionet e tjera dhe unë jam shumë e lumtur për këtë fakt.

Ka natyrisht disa gjëra që duhet t’i përmirësojmë: e para, duhet të përmirësohet vetëdija e zonjave për veten e tyre, pra përderisa një burrë në uniformë ndihet se mund ta shprehë lirshëm mendimin e tij, zonjat në uniformë janë më të ndjeshme ndaj kësaj dhe shpesh janë nguruese.

Pra, duhet ta rregullojmë dhe balancojmë realitetin e përditshëm që ndodh në Ministrinë e Mbrojtjes dhe

në strukturat e Forcave të Armatosura, sepse shpesh fatkeqësisht opinioni publik është ky që: “gratë që kërkojnë janë të vështira ndërsa burrat që kërkojnë janë të zotë” dhe ky është një mentalitet shoqëror që nuk është vetëm në Ministri të Mbrojtjes, është në çdo institucion shtetëror.

Fatmirësisht Shqipëria ka gra në role drejtuese, ka pasur gra në role më të larta drejtuese në Qeveri dhe mendoj që Shqipëria nuk ka probleme në sensin e barazisë gjinore, ka më shumë probleme në syrin e perceptimit social të rolit të gruas, që fillon nga kultura familjare deri te kultura institucionale.

Cilat janë sfidat dhe keqkuptimet më të shpeshta për gratë në Forcat e Armatosura?

Unë mendoj se ka disa keqkuptime, që duhet të sqarojmë, një nga keqkuptimet është se kolegët meshkuj shpesh mendojnë që gratë nuk dëshirojnë të kryejnë shërbime 24 orë etj., kur ne jemi një nga vendet, të cilat gjysmën e personelit që e kemi me shërbim jashtë vendit janë gra, pra ky është një keqkuptim që ndodh, nuk përkon me realitetin faktik, ky është një nga realitetet e para.

Nuk besoj që ne duhet të kemi politika specifike vetëm për të promovuar gratë, siç e thashë edhe një herë, unë besoj te barazia e njerëzve në uniformë, përtej gjinisë, që do të thotë, kur bëhet gjykimi i vlerësimit profesional të individëve në uniformë, ata duhet të gjykojnë në mënyrë specifike për misionin e tyre në Forcat e armatosura e jo për gjininë e tyre.

Për fat ne tashmë kemi dy gra një-yllëshe dhe natyrisht unë jam e sigurt që edhe me ndërrimet e mundshme të lidërshiptit në Ministrinë e Mbrojtjes nuk do të përfundojë këtu avancimi i grave në Ministrinë e Mbrojtjes, do të kemi edhe më shumë, kjo tregon që jemi në një pozitë shumë të volitshme.

Dhënia e shembullit, fakti që sot kemi dy gjenerale në detyrë – ku njëra prej tyre mban postin e zëvendës komandantes së Forcës Tokësore – është dëshmi e qartë e rolit të grave në ushtri.

Forca Tokësore e Republikës së Shqipërisë është struktura më e zhvilluar e Forcave të Armatosura, dhe misionet më të mëdha të NATO-s, realizohen kryesisht përmes saj. Ky fakt tregon qartë rëndësinë e kontributit të grave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Misioni përmbushet vetëm kur gratë e tjera e kanë parë që paraardhëset e tyre janë të suksesshme, me shembuj e jo me fjalë. Unë besoj fort te shembulli praktik. Nuk jam nga ato lidere që thotë “bëni se do t’ju mbështes”, ta shohim në praktikë dhe nga kjo pastaj çdo gjë bëhet më e lehtë.

Sa i rëndësishëm është roli i edukimit dhe mentorimit në formimin e lidërshiptit?

Unë nuk besoj të ketë një njeri të rritur që nuk ka pasur idhull të parë mësuesin apo mësuesen. Ne të gjithë adhurimin e parë në jetë kemi pasur një mësuese apo një mësues që na ka shtyrë në jetë. Unë personalisht i kam mbajtur raportet me një ose dy nga ata, të cilët kanë ndikuar shumë në jetën time dhe ata janë mentorët e parë të jetës, sepse njeriu përveç prindit, ka nevojë për një figurë që e kupton talentin individual të secilit individ dhe e ushqen këtë talent individual të kthehet në profesion, në vokacion, në mision etj.

Akademia e Forcave të Armatosura së bashku me Kolegjin, janë shtylla jashtëzakonisht të rëndësishme të edukimit kombëtar. Pse them edukim kombëtar, sepse përtej asaj që përgatisin liderë për forcat e armatosura, ne dimë që shumë liderë që kanë dalë si nga shkolla e mesme “Skënderbej”, si nga Kolegji, si nga kurset e larta të Kolegjit, si nga Akademia, janë sot në pozita drejtuese.

Njerëz që kanë drejtuar Policinë e Shtetit me vite të tëra, njerëz që kanë pasur pozita këshillë-dhënie shumë të larta të lidërshiptit të shtetit; kemi Presidentin e Republikës së Shqipërisë që vjen nga ambienti ushtarak dhe kjo ka ndodhur rëndom në Shqipëri për shkak të autoritetit.

Pra, forcat e armatosura dhe mënyra se si edukohen njerëzit në forcat e armatosura janë kontribut që i jepet jetës në Shqipëri në çdo formë, në çdo mënyrë dhe në çdo dikaster. Unë mendoj që nuk ka shërbyes më të mirë se disiplina dhe nuk ka mjeshtër më të mirë se disiplina për jetën e njeriut, prandaj lavdërimet më të mëdha, jo vetëm për përkushtimin që kanë ata, por mësuesit, profesorët, mësime dhënësit dhe akademikët, kanë detyrën më të lartë, që po formësojnë një njeri jo vetëm akademikisht, por po formësojnë një njeri me idealet më të larta që t’i shërbejë Atdheut.

Ju falënderoj! Ajo që bëni është e çmuar!

Zëvendësministria BLERINA ABRAZHDA:



Përkrah Grave në Uniformë dhe Forcimit të Arsimit Ushtarak në Forcat e Armatosura

Takim me vlerë dhe mesazh frymëzues në prag të 7-8 Marsit

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, në kuadër të festave të 7-8 Marsit, zëvendësministria znj. Blerina Abrazhda priti një prej të pedagogëve të spikatura të arsimit ushtarak në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, nënkolonele Esmihan Durbaku.

Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe respekti të ndërsjellë, duke reflektuar jo vetëm vlerësimin institucional për kontributin e pedagogëve të sistemit arsimor ushtarak, por edhe përkushtimin e Ministrisë së Mbrojtjes ndaj rolit të grave në uniformë. Në këtë kuadër, zëvendësministria theksoi se 7-8 Marsi nuk është vetëm një moment simbolik festimi, por një rast për të reflektuar mbi përgjegjësinë kolektive për të mbështetur dhe fuqizuar gratë në çdo sektor të shoqërisë, veçanërisht në Forcat e Armatosura.

Arsimi ushtarak, themeli i profesionalizmit në Forcat e Armatosura

Gjatë bisedës, u vlerësua roli kyç që luan sistemi arsimor ushtarak në formimin e brezave të rinj të oficerëve dhe nënoficerëve. Akademia e Forcave të Armatosura mbetet institucioni kryesor në përgatitjen akademike, profesionale dhe etike të personelit ushtarak, duke garantuar standarde të larta trajnimi në përputhje me praktikat më të mira të vendeve aleate.

Zëvendësministria Abrazhda nënvizoi se investimi në arsim është investim në sigurinë kombëtare. Një ushtri moderne nuk ndërtohet vetëm mbi pajisje dhe teknologji, por mbi dije, disiplinë, integritet dhe aftësi drejtuese. Në këtë kuptim, profesorët e AFA-s përfaqësojnë shtyllën e padukshme, por thelbësore të forcimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

Nënkolonele Durbaku me përvojën e saj shumëvjeçare në fushën e arsimit ushtarak, është një ndër ato figura që ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin profesional dhe karakterial të dhjetëra e qindra efektivëve. Kontributi i saj përtej auditorëve përket në cilësi komanduese në terren, në përgatitje më të lartë operacionale dhe në përfaqësim dinjitoz të Shqipërisë në misione ndërkombëtare.

Vlerësim i veçantë për gratë në uniformë

Një nga mesazhet kryesore të këtij takimi ishte vlerësimi i rolit të grave në Forcat e Armatosura. Nga ana e zëvendësministres u ofrua një vlerësim i veçantë për kontributin e grave në uniformë, të cilat ajo i cilësoi si “një nga shtyllat më të rëndësishme të shoqërisë sonë”.

Ajo theksoi se gratë ushtarake nuk janë thjesht pjesë e strukturave, por bartëse të vlerave të profesionalizmit, përkushtimit dhe integritetit. Prania e tyre në pozicione drejtuese, akademike dhe operacionale është dëshmi e një transformimi të qëndrueshëm institucional dhe shoqëror.

Në një kohë kur sfidat e sigurisë janë gjithnjë e më komplekse, përfshirja e plotë e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe operacioneve përbën një avantazh strategjik. Diversiteti rrit cilësinë e vendimmarrjes, forcon kohezionin dhe rrit besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë.

Lidershipi pranë njerëzve, një domosdoshmëri, jo formalitet

Takimi i zhvilluar në prag të festave të 7-8 Marsit përçon një mesazh më të gjerë mbi rëndësinë e leadershipit të pranishëm dhe të angazhuar. Për një lider institucional, qëndrimi pranë njerëzve nuk është një gjest protokollar, por një detyrim moral dhe profesional.

Një drejtues që dëgjon, vlerëson dhe inkurajon, krijon një klimë besimi dhe motivimi. Në Forcat e Armatosura, ku disiplina dhe hierarkia janë elementë themelorë, dimensionin njerëzor të leadershipit bëhet edhe më i rëndësishëm.

Kur efektivët ndihen të mbështetur dhe të vlerësuar, ata janë më të gatshëm të përballojnë sfida, të marrin përgjegjësi dhe të japin maksimumin e tyre në shërbim të atdheut.

Zëvendësministria Abrazhda shprehu gatishmërinë e saj për të qenë përkrah grave në uniformë, jo vetëm përmes mesazheve publike, por përmes mbështetjes konkrete në politika, programe zhvillimi profesional dhe iniciativa që synojnë rritjen e barazisë së mundësive.

Ky angazhim përket në mbështetje për trajnime të avancuara, përfaqësim më të gjerë në strukturat drejtuese dhe krijimin e një mjedisi pune ku secili vlerësohet për meritë dhe performancë.

“

Gratë ushtarake nuk janë thjesht pjesë e strukturave, por bartëse të vlerave të profesionalizmit, përkushtimit dhe integritetit. Prania e tyre në pozicione drejtuese, akademike dhe operacionale është dëshmi e një transformimi të qëndrueshëm institucional dhe shoqëror.

Forcat e Armatosura, garanci e sigurisë dhe stabilitetit

Në diskutim u theksua gjithashtu rëndësia e Forcave të Armatosura si garanci e sovranitetit, integritetit territorial dhe kontributit të Shqipërisë në sigurinë rajonale dhe globale. Profesionalizmi i personelit është faktor kyç për përmbushjen me sukses të misioneve brenda dhe jashtë vendit.

Sistemi arsimor ushtarak është hallka që lidh vizionin strategjik me zbatimin praktik. Çdo oficer i mirëformuar është një investim afatgjatë për sigurinë kombëtare. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i ngushtë mes strukturave drejtuese të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve arsimore ushtarake është jetik për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm.

Një mesazh për brezat e rinj

Takime të tilla kanë gjithashtu një dimension simbolik dhe frymëzues për brezat e rinj, veçanërisht për vajzat që aspirojnë një karrierë në Forcat e Armatosura. Figura të suksesshme si nënkolonele Esmihan Durbaku dëshmojnë se përkushtimi, profesionalizmi dhe integriteti njihen dhe vlerësohen.

Mesazhi që përcillet është i qartë: Forcat e Armatosura janë një institucion i hapur për të gjithë ata që duan t'i shërbejnë vendit me dinjitet dhe përkushtim, pavarësisht gjinisë.

Takimi i zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes në prag të 7-8 Marsit nuk ishte vetëm një akt simbolik urimi, por një dëshmi konkrete e vlerësimit për arsimin ushtarak dhe për rolin e grave në uniformë. Ai riafirmoi rëndësinë e investimit në dije, në barazi dhe në leadership të përgjegjshëm.

Në një kohë sfidash të shumta, Forcat e Armatosura mbeten një ndër institucionet më të rëndësishme të shtetit. Forcimi i tyre kalon përmes profesionalizmit, arsimit cilësor dhe mbështetjes së vazhdueshme institucionale.

Dhe mbi të gjitha, kalon përmes një leadershipi që qëndron pranë njerëzve, sepse një lider i vërtetë nuk udhëheq nga distanca, por ec krah për krah me ata që i shërbejnë atdheut çdo ditë, me nder dhe përkushtim.

Arkitektët e Mendjes Strategjike, Profesorët që Formësojnë Elitën e Forcave të Armatosura



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefë e Sektorit të Botimeve

7 Marsi – Dita e Mësuesit
Drita e dijes në shërbim të Atdheut: Profesorët e Akademisë së Forcave të Armatosura

Më 7 Mars, në mbarë hapësirën shqiptare, përulemi me respekt para figurës së mësuesit, atij që ndez dritën e dijes dhe formon themelet e së ardhmes. Kjo datë përkujton hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë, më 1887, një ngjarje që shënoi kthesë historike për arsimin dhe identitetin tonë kombëtar. Por 7 Marsi nuk është vetëm një kujtesë historike; ai është një thirrje për reflektim mbi misionin e përhershëm të mësuesit, misionin për të formuar qytetarë të ndershëm, profesionistë të zotë dhe atdhetarë të përkushtuar.

Në këtë ditë të shenjtë për arsimin, vëmendja jonë ndalet veçanërisht tek profesorët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Ata janë mësuesit e elitës ushtarake shqiptare, arkitektët e mendimit strategjik, formuesit e karakterit të oficerëve dhe garantët e trashëgimisë më të mirë të traditës sonë ushtarake.

Mësuesi, komandant i dijes

Nëse në shkollat civile mësuesi ndërton themelet e personalitetit dhe kulturës, në Akademinë e Forcave të Armatosura profesori ka një përgjegjësi të dyfishtë: ai formon mendjen dhe forcon karakterin. Ai nuk jep vetëm njohuri teorike mbi strategjinë, taktikën, sigurinë kombëtare apo teknologjinë ushtarake; ai modelon vendimmarrjen në situata kritike, edukon ndjenjën e përgjegjësisë dhe kultivon disiplinën morale.

Një oficer i mirë nuk lind rastësisht. Ai është produkt i një procesi të gjatë formimi, ku dija, përvoja dhe shembulli personal i pedagogut janë vendimtarë. Profesorët tanë ushtarakë janë burim frymëzimi, sepse ata vetë shpesh kanë kaluar nëpër misione të vështira, kanë përjetuar sfida reale dhe e sjellin këtë përvojë në auditor, duke e kthyer mësimdhënien në një akt të gjallë dhe autentik.

Akademia, tempull i profesionalizmit dhe përkushtimit

Akademia e Forcave të Armatosura nuk është thjesht një institucion arsimor; ajo është një laborator i mendimit strategjik kombëtar. Aty ndërthuren tradita dhe moderniteti, përvoja historike dhe kërkimi shkencor bashkëkohor, doktrina kombëtare dhe standardet e aleancave ku Shqipëria bën pjesë.

Profesorët e Akademisë janë ura lidhëse midis brezave. Ata ruajnë trashëgiminë e përvojës ushtarake shqiptare, duke e përcjellë atë me përgjegjësi tek oficerët e rinj. Në të njëjtën kohë, ata janë të hapur ndaj risive, ndaj zhvillimeve



teknologjike dhe koncepteve të reja të sigurisë që dikton realiteti global.

Në një botë ku sfidat e sigurisë janë gjithnjë e më komplekse – nga kërcënimet hibride tek lufta kibernetike – roli i profesorëve ushtarakë bëhet edhe më i rëndësishëm. Ata janë ata që përgatisin mendjet që do të analizojnë, parashikojnë dhe menaxhojnë këto sfida.

Formimi i karakterit, shtylla e oficerit

Dija pa karakter është e mangët. Në auditorët e Akademisë nuk formohen vetëm specialistë të fushave të ndryshme, por mbi të gjitha liderë. Profesorët e Forcave të Armatosura e dinë

se çdo leksion është edhe një mësim morali, çdo diskutim është një ushtrim përgjegjësie, çdo vlerësim është një akt drejtësie.

Shembullipersonalipedagogutkapeshëtejjashtëzakonshme. Qëndrimi i tij, korrektësia, përkushtimi ndaj detyrës, respekti për uniformën dhe për studentin – të gjitha këto bëhen pjesë e formimit të oficerit të ri. Në këtë kuptim, profesori është një model që ndikon përtej librave dhe leksioneve.

Në këtë 7- Mars, ne nderojmë pikërisht këtë dimension të heshtur, por thelbësor të punës së tyre: përkushtimin e përditshëm, shpesh të padukshëm, që ndërton themelet e një ushtrie profesionale dhe të besueshme.

Dija si forcë strategjike

Në shekullin XXI, forca e një ushtrie nuk matet vetëm me pajisje apo armatime, por me cilësinë e mendimit të saj. Analiza, planifikimi, koordinimi, menaxhimi i krizave të gjitha kërkojnë përgatitje të lartë akademike.

Profesorët e Akademisë janë kontribuues aktivë në zhvillimin e doktrinës, në studimet strategjike dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. Ata marrin pjesë në konferenca, botime shkencore dhe projekte kërkimore, duke përfaqësuar me dinjitet institucionin dhe vendin tonë.

Në faqet e gazetës “Ushtria”, është e drejtë që sot të theksojmë se çdo sukses operacional, çdo mision i realizuar me profesionalizëm, çdo vlerësim pozitiv për Forcat e Armatosura, mban në vetvete edhe kontributin e atyre që qëndrojnë pas kuintave, profesorëve që kanë përgatitur kuadrot.

Mirënjohje dhe përgjegjësi për të ardhmen

7 Marsi është ditë falënderimi. Është momenti për t’u shprehur mirënjohje profesorëve të Akademisë së Forcave të Armatosura për sakrificën, përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre. Ata janë gardianët e standardit, ruajtësit e etikës dhe promovuesit e dijes.

Por kjo ditë është edhe një thirrje për përgjegjësi të vazhdueshme. Arsimi ushtarak duhet të mbetet prioritet strategjik. Investimi në formimin e pedagogëve, në kërkimin shkencor dhe në infrastrukturën akademike është investim në sigurinë kombëtare.

Brezi i ri i oficerëve ka nevojë për udhëheqje të fortë akademike, për mentorë që i sfidojnë, i frymëzojnë dhe i përgatisin për realitetet e një bote në ndryshim të shpejtë. Dhe kjo përgjegjësi qëndron mbi supet e profesorëve - mësuesve të elitës ushtarake shqiptare.

Në këtë 7 Mars, ndërsa kujtojmë traditën e arsimit shqip dhe misionin fisnik të mësuesit, le të përulemi me respekt para profesorëve të Akademisë së Forcave të Armatosura. Ata janë drita që ndriçon rrugën e oficerëve tanë, forca e qetë që ndërton sigurinë e vendit dhe zëri i arsyes në kohë sfida.

Gëzuar 7 Marsin – Ditën e Mësuesit!
Mirënjohje profesorëve që me dijen, integritetin dhe përkushtimin e tyre forcojnë themelet e Ushtrisë sonë dhe mbrojnë të ardhmen e Atdheut.

8 MARS – NJË DATË QË BASHKON GJEOGRAFINË DHE INFRASTRUKTURËN USHTARAKE

Nga themelet gjeodezike te projektimi strategjik, rrugëtimi i IGJIU-së në shërbim të Forcave të Armatosura



Në kalendarin institucional të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, 8 Marsi përfaqëson një datë me peshë të veçantë historike dhe profesionale. Është dita kur u hodhën themelet e dy strukturave kyçe për mbrojtjen kombëtare: Institutit Topografik të Ushtrisë dhe Institutit të Studimeve e Projektimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, dy shtylla që sot bashkohen në një emër të vetëm: Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU).

Kjo nuk është thjesht një datë përvjetori. Është një moment reflektimi mbi një mision të gjatë: garantimin e informacionit hapësinor, ndërtimin e bazës gjeodezike kombëtare, projektimin dhe standardizimin e infrastrukturës ushtarake në funksion të sigurisë dhe zhvillimit të vendit.

Rrënjët: Fillimet e punimeve gjeodezike në Shqipëri (1918–1927)

Punimet e para moderne gjeodezike në Shqipëri nisin në vitet 1918–1927 me kontributin e Institutit Gjeografik të Vjenës. Në këtë periudhë u realizuan hartat e para sistematike të territorit shqiptar, ku për herë të parë u zbatuan metoda fotogrametrike me fotografi ajrore të marra nga aerostati – një risi teknologjike për kohën.

Këto punime shënuan fillimin e institucionalizimit të informacionit hapësinor në vendin tonë.

Më 17 shtator 1927, krijohet grupi i parë gjeodezik me 13 specialistë. Detyra e këtij shërbimi ishte e qartë:

- Plotësimi i nevojave të ushtrisë me harta dhe materiale hartografike;
- Organizimi i përgatitjes topografike të ushtarakëve;
- Sigurimi i bazamentit gjeodezik për nevoja ushtarake.

Ky ishte hapi i parë drejt ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm hartografik në shërbim të mbrojtjes.

Një tjetër moment i rëndësishëm ishte 10 gushti 1965, kur u shtyp harta e parë shqiptare me nomenklaturë K-34-87-D-b – një arritje që dëshmonte pjekurinë teknike të shërbimit hartografik vendas.

8 Mars 1975, Krijimi i Institutit Topografik të Ushtrisë

Më 8 mars 1975, me vendim të Këshillit të Ministrave, u krijua Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, me qendër në Tiranë.

Instituti u formua nga bashkimi i dy reparteve ekzistuese – Repartit të Topografisë dhe Repartit të Hartografisë – që ushtronin aktivitetin e tyre që nga dhjetori 1961.

Në vendimin themelues përcaktohej qartë misioni i ITU-së: një institucion ushtarak, kërkimor dhe prodhues në fushën e përgatitjes gjeografike të ushtrisë shqiptare.

Detyrat e tij përfshinin:

- Hartimin e politikave për grumbullimin dhe administrimin e informacioneve gjeografike;
- Organizimin e përgatitjes topogjeodezike të territorit;
- Përgatitjen e literaturës topografike dhe gjeografike ushtarake;
- Planifikimin e rezervave me harta topografike, tematike e speciale;
- Zhvillimin e veprimtarisë studimore e shkencore në fushat përkatëse.

Struktura organizative e ITU-së përfshinte Drejtorinë, Degën e Planifikimit dhe Kontrollit, sektorët e punimeve gjeodezike, fotogrametrike, topografike dhe hartografike, si dhe Laboratorin Optiko-Mekanik – një bërthamë teknike e kohës.

Rrjeti i Ri Gjeodezik, një arritje kombëtare

Një nga veprat më të rëndësishme të institutit ishte krijimi i Rrjetit të ri Gjeodezik të Shqipërisë, i përfunduar në vitin 1986.

Ky rrjet përbën bazën matematikore të të gjitha hartave dhe projekteve inxhinierike në vend. Ai ishte themeli mbi të cilin u mbështetën:

- Planifikimi urban
- Investimet infrastrukturore
- Ndërtimet strategjike
- Hartografia ushtarake dhe civile.

Në vitin 1983 u krijua seksioni shkencor i institutit, me

mision projektimin dhe zbatimin e detyrave topogjeodezike. Në vitin 1992 ai mori emrin Bordi Shkencor, ndërsa në vitin 2001 u quajt Departamenti Kërkimor dhe i Projekteve.

Ky evolucion dëshmon për një institucion që jo vetëm prodhonte harta, por zhvillonte mendim shkencor.

Partneriteti me SHBA-të dhe kalimi në standardet NATO

Në vitin 1994 u nënshkrua marrëveshja midis ITU dhe Agjencisë Hartografike të SHBA, e njohur si NIMA (National Imagery and Mapping Agency).

Qëllimi i marrëveshjes ishte:

- Bashkëprodhimi dhe shkëmbimi i hartave;
- Shkëmbimi i informacioneve detare, ajrore, gjeodezike dhe gjeofizike;
- Modernizimi i sistemit hartografik sipas standardeve të NATO-s.

Projekti më i rëndësishëm ishte përtëritja e hartave topografike sipas standardeve të reja të NATO-s, i cili përfundoi në vitin 2001.

Në tetor 1994, u kryen edhe fushatat e para të matjeve me GPS në Shqipëri. Rezultatet e tyre u përdorën për përgatitjen e bazës matematike të hartave të reja, duke shënuar hyrjen në epokën e teknologjisë satelitore.

Në mars të vitit 2000, me rastin e 25-vjetorit të krijimit, institucioni mori emrin Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë (IGJU).

Në vitin 2005, me dekret nr. 4515, datë 18.03.2005, IGJU u nderua me “Medaljen e Mirënjohjes” nga Presidenti i Republikës për kontributin e çmuar në fushën e gjeodezisë dhe hartografisë shqiptare.

ISPMB, Shtylla e projektimit ushtarak

Po më 8 mars 1975, u krijua edhe Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Ministrisë së Mbrojtjes (ISPMB).

Në varësi direkte të Ministrit të Mbrojtjes, ISPMB kishte mision:

- Studimin dhe projektimin e objekteve ushtarake;
- Standardizimin dhe certifikimin e infrastrukturës;
- Mbështetjen e FA-ve në investime dhe objekte

strategjike;

- Asistencën në procesin e demontimit të municioneve jashtë përdorimit.

Pas vitit 2014, pas bashkimit me IGJU, Departamenti i Infrastrukturës (ish-ISPMB) u përqendrua në realizimin e projekteve infrastrukturore për investimet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky bashkim krijoi një sinergji të natyrshme: Gjeografia jep informacionin hapësinor. Infrastruktura e materializon atë në terren.

2014 – Lindja e IGJIU dhe zgjerimi i misionit

Në qershor 2012 IGJU kaloi në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në korrik 2014, me riorganizimin e ri strukturor, IGJU u bashkua me ISPMB dhe mori emrin Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU).

Po në vitin 2014, strukturës së IGJIU-së iu bashkua edhe Inspektorati i Mjedisit (Sektori i Mjedisit), duke zgjeruar misionin drejt mbrojtjes së mjedisit në kuadër të veprimtarisë ushtarake.

Sot IGJIU përfaqëson:

- Autoritetin hartografik ushtarak;
- Qendrën kërkimore gjeodezike;
- Strukturën projektuese të infrastrukturës ushtarake;
- Garantin e standardizimit dhe certifikimit teknik;
- Mbështetjen mjedisore të strukturave të FA-së.

8 Marsi - Festë e profesionalizmit dhe përgjegjësisë

Në një botë ku informacioni hapësinor është faktor strategjik, roli i IGJIU-së është më i rëndësishëm se kurrë. Çdo projekt infrastrukturë, çdo plan operacional, çdo investim strategjik mbështetet mbi të dhëna të sakta gjeodezike dhe hartografike.

8 Marsi nuk është thjesht një përvjetor institucional. Është dita e profesionistëve që matin, projektojnë, analizojnë dhe ndërtojnë. Është dita e atyre që në heshtje vizatojnë sigurinë kombëtare. Sepse harta nuk është vetëm dokument teknik. Është bazë sovraniteti. Dhe infrastruktura nuk është vetëm beton e çelik. Është strukturë e qëndrueshmërisë së mbrojtjes kombëtare.

Gëzuar 8 Marsin, ditën e IGJIU!



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Një rrugëtim i shkurtër, me gjurmë të thella

Muhamet Hazbi Ajazi u lind më 28.07.1951, në Babicë të Vlorës, në një familje të thjeshtë, me tradita liridashëse dhe dashuri për dijen. Arsimin fillor dhe 7-vjeçar e kreu në vendlindje (1958-1965), duke u dalluar çdo vit për rezultate të shkëlqyera. Shkollën e mesme e përfundoi në Gjimnazin “Halim Xhelo” në Vlorë (1965-1969), ku spikati veçanërisht në shkencat ekzakto, në matematikë dhe fizikë.

Më 28 gusht 1969, nisi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, të cilat i përfundoi më 30 dhjetor 1971, duke u diplomuar oficer Gjitharmësh. Për rezultate shumë të mira u emërua pedagog në të njëjtin institucion, detyrë që e mbajti nga janari 1972 deri në fund të jetës. Në vitin 1985 u emërua shef i Katedrës Gjitharmësh, ndërsa në vitin 1990 mori gradën Major.

Ai u angazhua në kualifikim shkencor, zotëronte gjuhën angleze dhe italiane, si dhe fliste serbo-kroatisht. Pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë në Tiranë më 24.02.1994, duke lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë në moshë të mitur.

Edhe në ditët e fundit nuk reshti së shkruari. La pas një fond të pasur dokumentacioni dhe materialesh mësimore, të vlerësuara e të studiuara nga studentë dhe pedagogë të shkollave ushtarake.

“Më ndezi zjarrin për lëndën e zjarrit”

Pedagog Muhamet Ajazi, që në takimin e parë vëren se rrezaton mençuri, mirësi, modesti dhe altruizëm. Thëksoj se grupi mësimor nën drejtimin e tij ishte i disiplinuar, korrekt, shembullor. Pedagogu ofroi një bashkëpunim të shkëlqyer dhe u bë motiv për ecurinë e studimeve për mua dhe për studentët e tjerë. Si pedagog i lëndës së Zjarrit, ai ishte i jashtëzakonshëm. Shpjegonte me pasion, me përqendrim të plotë dhe me një saktësi që impononte respekt. Nuk ishte thjesht transmetues njohurish; ai kërkonte që studenti ta përvetësonte mësimin në auditor. Çdo çështje e rëndësishme e përsëriste disa herë, derisa të ishte e qartë për të gjithë.

Për shumë studentë, lënda e zjarrit u bë e dashur falë tij. Ai e kthente një disiplinë teknike në një fushë ku teoria lidhej drejtpërdrejt me përgjegjësinë profesionale: të zotëroje armën, ta përdorje me efektshmëri dhe me vetëdije.

Me të vetmen lëndë që pata “miqësi” ishte lënda e zjarrit dhe këtë lëndë ma bëri të dashur pedagogu im Muhamet Ajazi. Ai ishte shumë pasionant me mësimin, e shpjegonte me zemër dhe sytë i lëshonin shkëndija kur fliste. Ishte i saktë dhe i përpiktë në çdo gjë që fliste, kishte mjaft njohuri për lëndën që shpjegonte, sa që katedrës ku kishte shënime i afrohej në fillim kur fillonte mësimin dhe në fund kur mbyllte shënimet... ai ishte gjatë gjithë orës së mësimi i përqendruar tek tema e misionit dhe këtë kërkonte që studenti ta përvetësonte mësimin që në auditor dhe çdo çështje e përsëriste disa herë. Lënda e zjarrit ishte lënda që më tërhoqi më shumë. Tek kjo lëndë ishte dhe rezymja e përgjithshme e përgatitjes se sa i aftë ishe që të zotëronte një armë dhe këtë armë të dije ta përdorje dhe t’i merrje rezultatet e saj në qitjet që zhvilloheshin në atë kohë pa kursim...

Nën udhëheqjen e tij, përgatita tema diplome me bazë të fortë teorike dhe praktike, si “Bazimi teorik i kërkesës për sigurimin e dendësisë së nevojshme të zjarrit në të gjitha drejtimet dhe sektorët që mbrohen”.

Gjatë gjithë vitit të tretë, por edhe gjatë praktikës, si dhe qëndrimin prej një muaji në shkollë para se ta mbroja, pedagogu Muhamet Ajazi e kisha dhe udhëheqësin e diplomës. Më sugjeroi që në fillim të shpjegoja zjarrin, llojet e zjarrit dhe kërkesat për të qenë zjarr i efektshëm. Këtë e praktikova gjatë vitit të stazhit me togën dhe kompaninë që drejtoja. Më tej më sugjeroi për të bërë bazimin teorik të kërkesave për të siguruar që kompania këmbësore në të gjitha drejtimet dhe sektorët që mbron të hedhë 6-7 plumba për metër linear. Në vitin e stazhit u takova disa herë me pedagogun dhe saktësuam mjaft nga problematikat që kërkonte tema e diplomës. Në 37 faqe të temës argumentova kërkesën pse 6-7 plumba për metër linear. Tema u pëlqye nga komisioni dhe pedagogut i shkëlqeu fytyra. Kisha bërë një punë të mirë dhe u vlerësua shumë mirë, në sajë të kontributit dhe të këshillave të vijueshme të pedagogut të zjarrit Muhamet Ajazi.

Ai këmbëngulte që çdo përfundim të mbështetej në argument, në llogaritje dhe në provë praktike. Rezultati ishte formimi i oficerëve që mendonin, jo thjesht zbatonin. Mbeten në kujtesë shpjegimet e pedagogut sidomos për lëndën e zjarrit, por dhe përgatitja për qitje dhe qitje në poligonet e shkollës.

Në stërvitje dhe në mësim pedagogu performonte si një ushtarak i rrallë që shqyrtonte me imtësi veprimet e tij dhe

MUHAMET AJAZI – Lëndën e zjarrit e kthente në zjarr të brendshëm



të studentëve ndaj komandave për përgatitje dhe për zjarr, veprimet luftarake të zhvilluara dhe përvojën e ushtrisë shqiptare në përgatitje dhe në qitje, duke na mundësuar përgjithësimin e përvojës pozitive, por dhe evidentimin e mangësive të shfaqura, etj.

Kontributi studimor dhe tekstet mësimore

Gjatë viteve si pedagog, Muhamet Ajazi realizoi dhe bashkautorësoi një sërë tekstesh dhe rregulloresh që u bënë bazë në përgatitjen e kuadrove: “Bazat teorike të qitjes me armët e këmbësorisë” (1985); “Ustrimet e qitjes me armët e këmbësorisë” (1988); “Përgatitja për qitje me armët e këmbësorisë” (1993); “Rregullore e ushtrimeve të qitjes” (bashkautor, 1985); “Përgatitja për qitje natën” (bashkautor, 1974).

Ai kontribuoi në përgatitjen e leksioneve metodike mbi organizimin e sistemit të zjarrit në mbrojtje dhe në sulm me armët e këmbësorisë, ndikimin e kushteve meteorologjike në saktësinë e qitjes, kolaudimin e armëve, *përgatitjen për qitje kundër objekteve të lëvizshme në luftim mbrojtës*, mënyrat dhe rregullat e qitjes natën, *mënyrat dhe rregullat e qitjes kundër objektivave që ndriçohen natën*, si dhe përdorimin e mortajës 60 mm.

Gjithashtu mori pjesë në studime dhe eksperimentime praktike për harxhimin e municionit në mbrojtje e në sulm, përcaktimin e sektorëve të zjarrit për modele të ndryshme armësh dhe parametrat tekniko-luftarakë të armëve të prodhimit vendas. Kontribut dha edhe në përgatitjen e zërave të fjalorit enciklopedik ushtarak dhe në hartimin e programeve mësimore për specialitete të ndryshme.

Një kontribut dha në punën shkencore në përgatitjen e recensave dhe oponencave të ndryshme si për organizimin e drejtim të zjarrit me armët e këmbësorisë, për mortajën model 60 mm dhe për probleme e detyra për rritjen e efektshmërisë së zjarrit me armët e këmbësorisë.

Në mbi 15 vite si pedagog, realizoi më shumë se 16 mijë orë mësimore, mori pjesë në stërvitje e studime në shkallë ushtrie dhe përgatiti kumtesa në sesione shkencore.

Vlerësime dhe mirënjohje

Nga Presidiumi i Kuvendit Popullor u dekorua me “Medaljen e Shërbimit Ushtarak” me motivacion për punë me ndërgjegje dhe për kontribut në rritjen e përgatitjes ushtarake dhe disiplinës. Pas vdekjes, u vlerësua me certifikatë mirënjohjeje nga Shoqata Atdhetare Kulturore “Vranishti”, për kontributin si pedagog, studiues dhe oficer i përkushtuar që nderoi shkollën, ushtrinë dhe vendlindjen.

Një figurë për reflektim

Jeta e Muhamet Ajazit ishte e shkurtër, por e mbushur me përkushtim. Ai nuk la pas pasuri materiale, por la dije, metoda, libra, studentë të formuar dhe një standard pune që kërkon seriozitet e përgjegjësi.

Kur kujtojmë figura të tilla, nuk mjafton vetëm nderimi. Duhet të pyesim veten: a po i ruajmë dhe po i rrisim këto vlera? Shoqëritë përparojnë kur nderojnë dijen, disiplinën dhe përkushtimin, jo vetëm me fjalë, por me veprime.

Muhamet Ajazi ishte nga ata pedagogë që e bënte lëndën e zjarrit një zjarr të brendshëm për dijen dhe detyrën. Dhe ky është një trashëgim që nuk shuhet lehtë.

Një ditë për reflektim dhe nderim

8 Marsi nuk është thjesht një datë në kalendar. Është një ditë për të ndalur, për të reflektuar dhe për të nderuar çdo grua në jetën tonë. Çdo grua është një histori, një shembull, një forcë që ndryshon botën në mënyra të vogla dhe të mëdha. Ato janë arkitektet e jetës, që ndërtojnë themelet e familjes, formojnë shoqërinë dhe frymëzojnë të ardhmen.

Në këtë ditë, ne kujtojmë sakrificën, dashurinë, vendosmërinë dhe guximin e grave që punojnë pa u lodhur, shpesh në heshtje, për të bërë botën një vend më të mirë. Çdo buzëqeshje, çdo fjalë e thënë me dashuri dhe çdo veprim i vogël ka një ndikim të madh.

Gruaja në familje: Shtylla e dashurisë

Gruaja është zemra që rreh në çdo familje. Ajo nuk është vetëm nënë, motër apo bashkëshorte ajo është një burim pa fund i forcës, kujdesit dhe mençurisë. Me durim dhe përkushtim, ajo edukon karakterin e brezave të rinj dhe ndihmon në krijimin e një ambienti ku dashuria dhe respekti janë parimet kryesore.

Çdo fjalë e saj, çdo këshillë dhe përqafim, formon themelet mbi të cilat rriten brezat e ardhshëm. Gruaja është gjithmonë aty e qëndrueshme, e durueshme dhe e gatshme për çdo sfidë. Në mënyrë të padukshme, ajo ndërton urat mes brezave, duke përçuar vlera dhe tradita që qëndrojnë përjetësisht.

Gruaja në punë: Fuqi dhe profesionalizëm

Në botën profesionale, gruaja sfidon barrierat, ndërtuar karrierën dhe tregon se suksesi nuk ka gjini. Ajo është mësuese, doktoreshë, inxhinieri, ushtarë apo artiste, secila me forcën dhe vendosmërinë e saj të gjurmë të pashlyeshme.

Profesionalizmi i grave është frymëzim. Çdo projekt, çdo iniciativë dhe çdo arritje tregon se fuqia dhe talenti janë të barabartë me çdo sfidë që paraqitet. Ato janë shembull i vendosmërisë, kreativitetit dhe aftësisë për të transformuar çdo ide në realitet.

Në një botë ku sfidat janë të shumta, gratë jo vetëm që i përballojnë ato, por i përdorin për të ndërtuar një të ardhme më të fortë dhe më të qëndrueshme.

Gruaja në shoqëri: Udhëheqëse e butë

Gruaja nuk ndalet vetëm në familje apo zyrë. Ajo frymëzon shoqëri, udhëheq dhe bashkon njerëzit. Aftësia për të dëgjuar, për të kuptuar dhe për të vepruar me mençuri e bën atë një udhëheqëse të butë, por të fortë.

Çdo gjest, çdo fjalë dhe çdo vendim i grave ka ndikim të qëndrueshëm në komunitet. Ato nuk kërkojnë lavdi, por veprimi i tyre ndikon thellë në jetën e njerëzve. Në këtë mënyrë, gruaja shfaqet si një arkitekte e shoqërisë, duke krijuar urat e bashkëpunimit, respektit dhe solidaritetit.

Arkitektja e jetës: Artizane e ëndrrave

Çdo grua është një artizane e jetës. Ajo ndërton botën me imagjinatë, durim dhe dashuri. Çdo gjest i saj, qoftë një buzëqeshje, një fjalë inkurajuese apo një veprim që ndryshon jetën e dikujt, është pjesë e një ndërtese më të madhe, një bote më të bukur dhe më të drejtë.

Gruaja tregon se jeta nuk ndërtohet vetëm me gurë dhe beton, por me vizion, emocione dhe përkushtim. Ajo është arkitektja e ëndrrave që bëhen realitet, simboli i fuqisë dhe bukurisë së brendshme që çdo ditë i jep shoqërisë një dimension më human dhe më të ndjeshëm.

Në këtë 8 Mars, le të nderojmë çdo grua – nënë, motër, mësuese, ushtarë, shoqe, lidere. Ato janë arkitektet e jetës, shpirta të fortë dhe zemra të mëdha. Çdo ditë ato ndërtojnë të ardhmen tonë me dashuri, guxim dhe përkushtim.

Dita e Gruas është një kujtesë për të njohur, vlerësuar dhe mbështetur gratë jo vetëm sot, por gjatë gjithë vitit. Ato janë burim frymëzimi dhe energjie, dhe rol i tyre është themelor në çdo aspekt të jetës. Le të festojmë fuqinë, bukurinë dhe guximin e tyre, sepse çdo grua është një arkitekte e jetës, dhe bota jonë do të ishte më e varfër pa to.

Urim pecial i redaksisë së shtypit ushtarak

Të nderuara gra në uniformë, Të dashura ushtarake, oficerë, nënoficerë dhe punonjëse të Forcave të Armatosura,

Me rastin e **8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas**, ju shprehim mirënjohjen, respektin dhe admirimin më të thellë për kontributin tuaj të jashtëzakonshëm në shërbim

8 MARS DITA E GRUAS, ARKITEKTES SË JETËS



të atdheut. Kjo ditë nuk është vetëm një festë simbolike, por një moment reflektimi mbi forcën, përkushtimin, sakrificën dhe profesionalizmin që ju mishëroni çdo ditë me dinjitet në uniformën që mbani.

Gruaja në uniformë është simbol i guximit dhe përgjegjësisë. Ajo qëndron e palëkundur përballë sfidave, përballon me vendosmëri detyrat më të vështira dhe përfaqëson me krenari vlerat më të larta të shërbimit ushtarak: disiplinën, besnikërinë, integritetin dhe përkushtimin ndaj misionit. Në çdo repart, në çdo mision brenda dhe jashtë vendit, në çdo operacion humanitar apo paqeruajtës, kontributi juaj është i pazëvendësueshëm.

Sot, më shumë se kurrë, roli i gruas ushtarake ka marrë një dimension të ri dhe të fuqishëm. Ju nuk jeni vetëm pjesë e strukturave të sigurisë dhe mbrojtjes, ju jeni shtyllë e tyre. Prania juaj forcon ekipin, rrit standardet profesionale dhe sjell një perspektivë të çmuar në vendimmarrje, në udhëheqje dhe në menaxhimin e situatave komplekse.

Të qenit grua dhe njëkohësisht ushtarake kërkon forcë të dyfishtë. Kërkon të ruash ndjeshmërinë dhe humanizmin, ndërsa përballësh me situata që kërkojnë vendosmëri dhe qëndrueshmëri. Kërkon të balancosh jetën familjare me detyrën, emocionin me disiplinën dhe shpeshherë sakrificën personale me përgjegjësinë kombëtare. Ju e bëni këtë çdo ditë me përkushtim dhe dinjitet, duke qenë shembull frymëzimi për brezat e rinj.

Gratë në uniformë janë dëshmi e gjallë se profesionalizmi nuk njih gjini, se aftësia dhe lidërshipi nuk kufizohen nga paragjykimet, dhe se barazia ndërtohet përmes punës, meritës dhe përkushtimit. Ju keni thyer barrierat, keni hapur rrugë dhe keni dëshmuar se vendi i gruas është aty ku kërkohet vendosmëri, inteligjencë dhe guxim – edhe në vijën e parë të detyrës.

Në çdo trajnim të vështirë, në çdo marshim të gjatë, në çdo natë shërbimi, në çdo mision larg familjes, ju përfaqësoni jo

vetëm forcën e armatosur, por edhe forcën e karakterit. Ju jeni modele të disiplinës dhe profesionalizmit, por edhe të empatisë dhe bashkëpunimit, cilësi që e bëjnë një ushtri më të fortë dhe më njerëzore.

Rëndësia e gruas ushtarake nuk matet vetëm me gradën që mban në supe, por me ndikimin që lë në ekip, në institucion dhe në shoqëri. Ju kontribuoni në ndërtimin e një kulture organizative më gjithëpërfshirëse, më të drejtë dhe më të fortë. Përmes punës suaj, ju dëshmoni se siguria kombëtare është përgjegjësi e përbashkët dhe se suksesi arrihet kur talenti dhe përkushtimi vlerësohen pa dallim.

Sot, në këtë ditë të veçantë, ne nderojmë jo vetëm arritjet tuaja profesionale, por edhe forcën tuaj si nëna, bija, motra dhe bashkëshorte. Roli juaj në familje dhe në shoqëri është po aq i rëndësishëm sa edhe ai në uniformë. Ju jeni ura që lidhni ndjenjën me detyrën, sakrificën me shpresën, dhe forcën me dashurinë.

Le të jetë 8 Marsi një rikujtim se përkushtimi juaj nuk kalon pa u vënë re. Se puna juaj vlerësohet. Se sakrifica juaj nderohet. Dhe se kontributi juaj është thelbësor për sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin e vendit tonë.

Ju falënderojmë për profesionalizmin, për besnikërinë ndaj betimit, për guximin për të përballuar sfidat dhe për shembullin që jepni çdo ditë. Faleminderit që jeni frymëzim për vajzat e reja që ëndërrojnë të veshin uniformën me krenari. Faleminderit që jeni zë i barazisë dhe simbol i forcës në institucionet tona.

Në emër të respektit dhe mirënjohjes sonë më të thellë, ju urojmë shëndet, suksese të mëtejshme në karrierë, mbështetje të vazhdueshme dhe realizim të plotë të potencialit tuaj. Qofshi gjithmonë krenare për uniformën që mbani dhe për rrugën që keni zgjedhur të ndiqni.

Gëzuar 8 Marsin!

Me respekt dhe mirënjohje të thellë për çdo grua në uniformë.

BESËLIDHJA E LEZHËS: 582 VITE NGA AKTI QË E KTHEU BASHKIMIN NË FUQI SHTETFORMUESE

Më 2 mars 1444, në qytetin e Lezhës, princërit shqiptarë lanë mënjanë rivalitetet, interesat krahinore dhe ambiciet personale për t'u bashkuar në një aleancë të përbashkët ushtarake e politike. Kjo ngjarje, e njohur në histori si Besëlidhja e Lezhës, nuk ishte thjesht një marrëveshje mes fisnikësh. Ishte një akt shtet-formues, një moment kthese ku bashkimi triumfoi mbi përçarjen dhe përgjegjësia kombëtare mbi interesin individual.

582 vite më pas, Besëlidhja e Lezhës mbetet një standard i sjelljes politike dhe institucionale, një referencë e qartë për Forcat e Armatosura dhe për çdo strukturë që mban përgjegjësi mbi fatet e vendit.

Konteksti historik: Shqipëria mes përçarjes dhe rrezikut osman

Shekulli XV e gjeti hapësirën shqiptare të fragmentarizuar në principata të ndryshme feudale, të drejtuara nga familje fisnike me ndikim rajonal. Këto principata, ndonëse kishin tradita të forta luftarake, shpeshherë vepronin të ndara dhe në konkurrencë me njëra-tjetrën.

Ndërkohë, Perandoria Osmane po zgjerohej me shpejtësi në Ballkan. Pas rënies së një sërë fortesash dhe principatash, kërcënimi ndaj trojeve shqiptare ishte i drejtpërdrejtë dhe i pashmangshëm.

Në këtë realitet, figura e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut u shfaq si një faktor bashkues. Pas kthimit në atdhe dhe rimarrjes së Krujës në vitin 1443, ai kuptoi se qëndresa e suksesshme nuk mund të ndërtohej mbi veprime të izoluar, por mbi një front të përbashkët.

2 Mars 1444 – Akti i bashkimit në Lezhë

Më 2 mars 1444, në qytetin e Lezhës, në një mjedis që historikisht kishte qenë qendër e rëndësishme politike dhe kishtare, u mbledhën princërit shqiptarë për të lidhur një besëlidhje.

Ky kuvend njihet në histori si Besëlidhja e Lezhës.

Në këtë kuvend morën pjesë përfaqësues të familjeve më të njohura fisnike të kohës: Kastriotët, Arianitët, Dukagjinët, Muzakajt, Balshajt e të tjerë. Ata vendosën:

- Të bashkonin forcat ushtarake nën një komandë të përbashkët
- Të kontribuonin financiarisht për mbajtjen e ushtrisë
- Të koordinonin veprimet politike dhe diplomatike
- Të mbronin së bashku territoret e tyre kundër pushtimit osman.

Skënderbeu u zgjodh kryekomandant i forcave të përbashkëta. Ky vendim shënon një moment të rrallë në historinë mesjetare shqiptare: pranimin vullnetar të një autoriteti qendror në emër të interesit të përbashkët.

Besëlidhja nuk shkrinte autonominë e principatave, por krijonte një mekanizëm bashkërendimi dhe drejtimi strategjik. Ajo ishte një aleancë e lirë, e mbështetur mbi fjalën e dhënë mbi besën.

Nga aleancë ushtarake në simbol evropian të qëndresës

Pas Besëlidhjes së Lezhës, qëndresa shqiptare mori



një dimension të ri. Betejat e zhvilluara nën udhëheqjen e Skënderbeut, përfshirë mbrojtjen e Krujës dhe përballjet në Torvioll, Mokër e gjetkë, u kthyen në referenca të historisë evropiane të rezistencës ndaj Perandorisë Osmane.

Shqiptarët nuk luftuan vetëm për territoret e tyre, por u bënë pjesë e një narrative më të gjerë evropiane të mbrojtjes së lirisë dhe identitetit.

Besëlidhja e Lezhës dëshmoi se:

- Trimëria pa organizim është e pamjaftueshme;
- Forca pa koordinim është e brishtë;
- Udhëheqja pa legjitimitet nuk zgjat.

Nën frymën e vizionit të Skënderbeut, shqiptarët vepruan si një trup i vetëm. Kjo njësi veprimi u bë themeli i sukseseve ushtarake që zgjatën për më shumë se dy dekada.

Mesazhi i Besëlidhjes për Forcat e Armatosura sot

582 vite më pas, Besëlidhja e Lezhës nuk është vetëm një ngjarje e kalendarit historik. Ajo është një model funksionimi.

Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

mesazhi i saj është i qartë:

- Bashkërendimi institucional është kusht i suksesit operacional;
- Komanda e unifikuar është thelbësore në situata krize;
- Interesi kombëtar qëndron mbi çdo interes individual apo sektorial.

Në një kohë sfidash të reja nga rreziqet hibride të tensionet gjeopolitike – fryma e Besëlidhjes mbetet aktuale. Ajo na kujton se forca jonë si komb nuk ka qëndruar vetëm në trimëri, por në disiplinë, organizim dhe përgjegjësi. Skënderbeu nuk u bë figurë e historisë vetëm për aftësitë e tij luftarake, por për aftësinë për të bashkuar, për të ndërtuar besim dhe për të krijuar një strukturë funksionale të përbashkët.

Besëlidhja, standard politik dhe institucional

Në thelb, Besëlidhja e Lezhës ishte një akt i pjekurisë politike. Princërit shqiptarë pranuan se mbijetesa e përbashkët kërkonte kufizimin e ambicieve personale.

Ky standard mbetet aktual edhe sot:

- Në politikë, si nevojë për konsensus mbi çështjet madhore kombëtare;
- Në institucione, si domosdoshmëri e koordinimit dhe transparencës;
- Në mbrojtje, si garanci e funksionimit të një strukture të integruar.

Në histori, momentet e mëdha nuk maten vetëm nga fitoret ushtarake, por nga vendimet e guximshme për të vepruar së bashku.

Një kujtesë për brezat

Besëlidhja e Lezhës është dëshmi se bashkimi nuk është dobësi, por forcë e shumëfishuar. Ajo është një kujtesë se përgjegjësia ndaj atdheut kërkon tejkalimin e interesave të ngushta dhe vendosjen e së mirës së përbashkët në qendër të vendimmarrjes.

Për gazetën “Ushtria”, kjo datë është më shumë se përkujtim historik. Është thirrje për reflektim profesional dhe institucional. Sepse në thelb, fryma e 2 marsit 1444 mbetet e njëjtë:

Kur shqiptarët veprojnë si një trup i vetëm, ata bëhen pjesë e historisë. Dhe historia, ashtu si në Lezhë 582 vite më parë, shkruhet nga ata që dinë të bashkohen për një qëllim më të madh se vetja.



GRATË NË UNIFORMË

Heroina të paqes dhe SIGURISË

8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas, nuk është thjesht një datë kalendarike që shënohet me lule dhe urime. Ajo është një ditë reflektimi, një ditë kujtese dhe një ditë nderimi për të gjitha gratë që kanë luftuar, punuar dhe sakrifikuar për barazinë, dinjitetin dhe të drejtat e tyre. Në këtë ditë, bota ndalet për të parë jo vetëm arritjet e grave në fusha të ndryshme të jetës, por edhe sfidat e vazhdueshme që ato përballojnë. Një nga fushat ku kontributi i grave shpesh mbetet i padukshëm, por është i jashtëzakonshëm, është shërbimi ushtarak. Gratë në uniformë janë një realitet i gjallë në të gjitha kontinentet, duke dëshmuar se guximi, përkushtimi dhe profesionalizmi nuk kanë gjini.



Mbretëresha Teutë

Të veshura me uniformë, gratë ushtarake bartin mbi supe jo vetëm peshën e detyrës, por edhe barrën e paragjyqimeve historike. Për shekuj me radhë, ushtria është parë si një fushë e rezervuar për burrat, një arenë ku forca fizike dhe autoriteti i komandës lidhej ngushtë me figurën mashkullore. Megjithatë, historia ka treguar se gratë kanë qenë gjithmonë aty: si luftëtare të paepura në mbrojtje të atdheut, si infermiere që shpëtonin jetë në fushëbetejë, si strategë dhe udhëheqëse që frymëzonin trupa të tëra. Nga Nora e Kelmendit tek heroinat e Luftës së Dytë Botërore, nga pilotet sovjetike tek komandantet moderne të NATO-s, gratë kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake botërore.



Shote Galica

Në kohët moderne, prania e grave në ushtri nuk është më një përjashtim, por një realitet i konsoliduar. Ato shërbejnë në misione paqeruajtëse, udhëheqin operacione luftarake, marrin pjesë në trajnime të specializuara dhe ngjiten në hierarkinë ushtarake deri në gradat më të larta. Për shumë vende, përfshirja e grave në ushtri është jo vetëm një çështje barazie, por edhe një domosdoshmëri strategjike: diversiteti i trupave rrit efektivitetin, sjell perspektiva të reja dhe forcon lidhjen me komunitetet ku ushtria operon. Edhe Shqipëria nuk bën përjashtim. Gratë shqiptare në uniformë janë sot një pjesë e rëndësishme e Forcave të Armatosura, duke dëshmuar se tradita e guximit femëror



nuk ka humbur, por është përshtatur me kohën. Nga heroinat e historisë tek oficeret dhe nënoficeret e sotme, rrugëtimi i grave shqiptare në ushtri është një histori e pasur me sakrifica, arritje dhe krenari kombëtare. Në këtë 8 Mars, është e rëndësishme të ndalemi për t'i parë ato jo vetëm si pjesë e statistikave, por si individë që kanë zgjedhur një mision të vështirë e fisnik: mbrojtjen e atdheut dhe paqes.

Ky shkrim synon të sjellë një panoramë të gjerë mbi rolin e grave ushtarake në botë dhe në Shqipëri, duke i vendosur ato në qendër të vëmendjes në këtë ditë të veçantë. Sepse 8 Marsi nuk është vetëm një ditë për të folur për barazinë, por edhe për të nderuar gratë që çdo ditë, me uniformë apo pa të, mbajnë mbi supe barrën e përgjegjësive dhe idealit të lirisë.

GRATË USHTARAKE NË BOTË

Nga rolet ndihmëse tek komandat luftarake

Historikisht, gratë kanë qenë pjesë e ushtrive që nga Lufta e Parë Botërore, kryesisht si infermiere, komunikatore apo logjistikë. Me kalimin e kohës, ato u përfshinë edhe në misione luftarake. Lufta e Dytë Botërore solli një rritje të jashtëzakonshme të pjesëmarrjes së grave, sidomos në Bashkimin Sovjetik, ku mijëra gra shërbyen si snajperiste, pilote dhe komandante.

Roli në misionet paqeruajtëse

Gratë ushtarake janë të pranishme në misione të NATO-s, OKB-së dhe organizatave rajonale. Ato sjellin një qasje të veçantë në ndërveprim me komunitetet lokale, duke ndihmuar në ndërtimin e besimit dhe stabilitetit. Shumë studime tregojnë se prania e grave në misione paqeruajtëse rrit efektivitetin e komunikimit dhe ul tensionet me popullsinë vendase.

GRATË USHTARAKE SHQIPTARE

Nga historia tek e sotmja

Gratë shqiptare kanë qenë gjithmonë pjesë e luftërave për mbrojtjen e vendit. Figura si Nora e Kelmendit dhe heroinat e Rilindjes Kombëtare treguan se gratë nuk ishin vetëm mbështetëse, por edhe luftëtare aktive. Në

periudhën e Luftës së Dytë Botërore, shumë gra morën pjesë si partizane, komisarë dhe komandante.

Statistika aktuale

Sot, pjesëmarrja e grave në Forcat e Armatosura të Shqipërisë është rreth 15%.

- 20.84% janë oficerë,
- 13.44% nënoficerë,
- 11.37% ushtarë.

Në total, mbi 1300 gra ushtarake shërbejnë në FA, duke qenë pjesë e misioneve ndërkombëtare dhe strukturave të NATO-s. Ky është një tregues i qartë se barazia gjinore po bëhet realitet edhe në fushën ushtarake.

Figura frymëzuese

Vehbie Kurti, një ndër gratë e para që mori gradën e lartë ushtarake, është shembull i guximit dhe përkushtimit. Razije Mehmeti është një oficerë e lartë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, e cila në janar 2026 u gradua me titullin “Gjeneral Brigade”, duke u bërë një nga figurat më të rëndësishme femra në ushtrinë shqiptare. Majore Merita Allmuça ka treguar se shërbimi ushtarak është një mision i jetës, duke përballuar sfida personale e profesionale.

Kontributi në misione ndërkombëtare

Gratë shqiptare kanë qenë pjesë e misioneve në Afganistan, Irak, Bosnje-Hercegovinë dhe Mali i Zi. Ato kanë fituar respektin e aleatëve dhe kanë treguar se profesionalizmi nuk njeh gjini.

8 Marsi dhe gratë në uniformë

8 Marsi është një ditë reflektimi mbi barazinë gjinore dhe kontributin e grave në shoqëri. Për gratë ushtarake, kjo ditë ka një domethënie të veçantë: ajo nderon sakrificat, përkushtimin dhe guximin e tyre në mbrojtjen e vendit dhe paqes ndërkombëtare. Ministria e Mbrojtjes në Shqipëri e ka festuar shpesh këtë ditë me aktivitete që vlerësojnë gratë në uniformë, duke i konsideruar si shtylla të sigurisë kombëtare. Gratë ushtarake, si në botë ashtu edhe në Shqipëri, janë shembull i forcës, guximit dhe përkushtimit. Ato kanë thyer barrierë historike dhe sot janë pjesë e pandashme e strukturave ushtarake. Në 8 Mars, nderimi i tyre është një detyrim moral dhe kombëtar, duke treguar se barazia gjinore nuk është vetëm një ideal, por një realitet i arritur me sakrifica dhe punë të palodhur.



Teknologjia e Luftës Moderne, Realiteti Aktual dhe Perspektivat e Ardhshme

Situata aktuale e konflikteve në Lindjen e Mesme ka treguar qartë se fushëbetejat e shekullit XXI po transformohen. Sulmet e përsëritura me dronë dhe raketa balistike kanë vënë në provë sistemet e mbrojtjes ajrore dhe kanë krijuar pasiguri të madhe për popullsitë civile. Ky realitet ka shërbyer si nxitje për të analizuar rolin e teknologjisë në luftën moderne, duke parë jo vetëm përdorimin aktual të mjeteve pa pilot, por edhe drejtimin ku po shkon zhvillimi i armëve dhe strategjive ushtarake. Lufta nuk është më e kufizuar në tanket dhe avionët e rëndë, por është zhvendosur drejt mjeteve të vogla, të sofistikuara dhe digjitale.



Dronët si armë të përditshme

Dronët kanë kaluar nga mjetet e thjeshta të survejimit në instrumente të sofistikuara të luftës. Dronët kamikaz, të njohur si municione patrulluese, patrollojnë mbi objektiva dhe godasin në momentin e duhur, duke kombinuar rolin e raketës me atë të zbulimit. Krahas tyre, dronët e vegjël komercialë të përshtatur për përdorim ushtarak ofrojnë fleksibilitet dhe kosto të ulët, duke u bërë të aksesueshëm për aktorë të ndryshëm. Ky përdorim masiv ka treguar se dronët janë tashmë një element i pandashëm i fushëbetejës moderne, duke ndryshuar mënyrën e të menduarit për operacionet ushtarake.

Raketat balistike dhe presioni mbi mbrojtjen

Raketat balistike janë përdorur në mënyrë intensive, shpesh në kombinim me dronët, për të krijuar presion të vazhdueshëm mbi sistemet e mbrojtjes ajrore. Lëshimi i qindra raketave në një periudhë të shkurtër kohe ka treguar se mbrojtja tradicionale është e vështirë të përballojë një intensitet të tillë. Ky kombinim i mjeteve të vogla dhe raketave të fuqishme e bën fushëbetejën shumë më komplekse, duke e vështirësuar reagimin e shpejtë dhe efektiv. Për më tepër, raketat balistike janë përdorur jo vetëm për objektiva ushtarake, por edhe për të krijuar frikë dhe destabilitet në zonat urbane.

Asimetria e fuqisë

Një nga karakteristikat më të dukshme të luftës moderne është asimetria e fuqisë. Mjetet e vogla, të thjeshta dhe relativisht të lira, mund të shkaktojnë dëme të ndjeshme ndaj forcave më të mëdha dhe më të pajisura. Kjo ka ndryshuar balancën e fuqisë, duke u dhënë mundësi aktorëve më të vegjël të sfidojnë kundërshtarë më të mëdhenj. Dronët dhe raketat nuk janë thjesht armë, por instrumente strategjike që ndryshojnë mënyrën e të menduarit për luftën. Ky realitet



ka sjellë një dimension të ri: fuqia nuk matet më vetëm me numrin e trupave apo madhësinë e arsenalit, por me aftësinë për të përdorur teknologjinë në mënyrë kreative dhe efektive.

Lufta elektronike si front i ri

Me rritjen e përdorimit të dronëve, lufta elektronike është bërë po aq e rëndësishme sa vetë përdorimi i tyre. Ndërhyrja në sinjale GPS dhe sistemet kundër-dron janë tashmë pjesë e pandashme e fushëbetejës. Kontrolli i hapësirës ajrore të ulët është kthyer në një sfidë të re, pasi fushëbetejat mbushen me mjete të vogla që operojnë në mënyrë të koordinuar. Shpesh, këto mjete përdorin inteligjencë artificiale për të shmangur ndërhyrjet, duke e bërë edhe më të vështirë neutralizimin e tyre. Kjo tregon se lufta moderne nuk është më vetëm fizike, por edhe digjitale, ku betejat zhvillohen në valët e radios, në sinjalet satelitore dhe në rrjetet kompjuterike.

Automatizimi dhe inteligjenca artificiale

Integrimi i inteligjencës artificiale në operacionet ushtarake është një tjetër zhvillim i dukshëm. AI po përdoret për identifikimin e objektivave, shmangien e ndërhyrjeve elektronike dhe automatizimin e vendimmarrjes. Perspektiva e ardhshme është që flotat e dronëve, robotët tokësorë dhe mjetet pa pilot në det të operojnë në mënyrë të koordinuar, duke reduktuar nevojën për operatorë njerëzorë. Kjo do të sjellë një transformim të thellë në mënyrën se si konceptohet lufta, ku algoritmet dhe sistemet e automatizuara do të marrin vendime në kohë reale. Automatizimi pritet të ulë kostot, të rrisë shpejtësinë e reagimit dhe të minimizojë rrezikun për personelin ushtarak.

Armët energjetike dhe hipersonike

Përveç dronëve dhe raketave, teknologjitë e reja po formësojnë arsenalin e së ardhmes. Armët energjetike, si lazerët dhe sistemet me mikrovalë, pritet të përdoren për neutralizimin e dronëve dhe raketave, duke ofruar mbrojtje më të shpejtë dhe më ekonomike. Municionet hipersonike, me shpejtësi shumë të lartë, do të ndryshojnë balancën e mbrojtjes, duke e bërë reagimin tradicional më të vështirë. Këto armë do të kenë aftësinë të depërtojnë në mbrojtje të sofistikuara dhe të godasin objektiva në kohë rekord, duke e bërë fushëbetejën edhe më të paparashikueshme.

Lufta kibernetike si dimension i ri

Lufta kibernetike është një tjetër front i pazëvendësueshëm i konflikteve moderne. Ajo synon sistemet e komandës, kontrollit dhe komunikimit, duke e bërë teknologjinë digjitale një fushëbetejë më vite. Sulmet kibernetike mund të paralizojnë rrjetet e energjisë, sistemet e transportit dhe komunikimet ushtarake, duke krijuar një efekt domino mbi gjithë shoqërinë. Në këtë kontekst, mbrojtja kibernetike është po aq e rëndësishme sa mbrojtja fizike, pasi një sulm digjital mund të ketë pasoja të barabarta me një sulm fizik.

Situata aktuale në Lindjen e Mesme ka treguar se dronët dhe raketat janë tashmë pjesë e pandashme e luftës moderne. Ky realitet është një paralajmërim se luftërat e së ardhmes nuk do të përcaktohen më nga numri i trupave apo fuqia e tankeve, por nga dominimi teknologjik. Dronët, raketat, sistemet pa pilot, armët energjetike, municionet hipersonike dhe inteligjenca artificiale do të jenë elementët përcaktues të fushëbetejës. Kush zotëron teknologjinë më të avancuar, do të ketë avantazh vendimtar në konfliktet e ardhshme.



Raketa "Precision Strike" (PrSM) është një armë me rreze të shkurtër veprimi e prodhuar nga "Lockheed Martin". Imazhi: Ushtria Amerikane.





Studime NË AKADEMITË USHTARAKE TË ITALISË

E ardhmja juaj nis me uniformën!

Qendra e Personel Rekrutimit shpall 4 (katër)
kuota studimi në Akademitë Ushtarake të
Italisë, për vitin akademik 2026.

KUOTAT E STUDIMIT

Akademia Ushtarake e Modenës

- ✓ **1 (një) Mjekësi**
- ✓ **1 (një) Inxhinieri**
- ✓ **1 (një) Karabinieri**

AKADEMIA DETARE E LIVORNOS

- ✓ **1 (një) Inxhinieri Navale**

Afati i aplikimit:
Deri më 11 mars 2026

Kriteret kryesore të aplikimit:

- ✓ **Shtetësi shqiptare**
- ✓ **Mosha 18–22 vjeç**
- ✓ **Statusi beqar/e**
- ✓ **Mesatare mbi 7**
- ✓ **Njohuri të gjuhës italiane
(niveli 2/2/2/2)**
- ✓ **I/e aftë shëndetësisht dhe fizikisht**

Dokumentacioni

Dorëzohet pranë:

Zyra e Pranimiit – Tiranë

☎ **Tel: 04 234 8588**

☎ **WhatsApp: +355 68 340 4896**

Studio në një nga akademitë më prestigjioze
ushtarake në Evropë dhe ndërto karrierën
tënde në shërbim të Atdheut!

Për informacion të mëtejshëm klikoni linkun përkatës:

<https://www.mod.gov.al/.../270226/studime-itali-270226.pdf>